



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit*

Kabineti i Ministrimit  
Kabinet Ministra  
Minister's Office

Nr. 38/2015  
Datë: 31.03.2015

Ministri i Kulturës Rinisë dhe Sportit, z. Kujtim SHALA, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22, të Ligjit Nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (gazeta Zyrtare Nr. 82, 21 tetor 2012), duke u bazuar në nenin 8 ( paragrafi 1.4 ) dhe shtojcën 7 (shtatë) të rregullores Nr. 02/11, për fushat e përgjegjësive administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011) si dhe duke u mbështetur në nenin 30 të Ligjit Nr. 2004/22 për Kinematografinë, me datë 31.03.2015, mori këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Këshilli Drejtues i Qendrës Kinematografike të Kosovës.
2. Këshilli Drejtues përbëhet prej pesë anëtarë si në vijim:
  - 2.1 Agim Selimi
  - 2.2 Veton Nurkollari
  - 2.3 Selman Jusufi
  - 2.4 Ilir Gjocaj
  - 2.5 Zethane Gimolli- Bahtiri, përfaqësuese e MKRS-së.
3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues është 3 vjeçar dhe për punën e tyre kompensohen financiarisht.
4. Kompensimi lejohet në vlerë prej 125.00 (njëqindnjëzetepesë) euro për kryesuesin, ndërsa 100.00 (njëqind) euro për anëtarët e Këshillit për secilën mbledhje.

5. Kompensimi si në paragrafin 4 të këtij vendimi lejohet më së shumti për dy mbledhje të mbajtura gjatë muajit.
6. Këshilli Drejtues e kryen funksionin e tij duke u mbështetur ne detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin Nr. 2004/22 për Kinematografinë dhe në statutin e QKK-së.
7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kujtim SHALA  
Ministër

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Ministrisë,
- Zyrës së sekretarit të përgjithshëm,
- Anëtarëve të emëruar,
- Departamentit Ligjor,
- Departamentit të Kulturës,
- Arkivit të MKRS-së,
- QKK-së.

